



## **PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

### **Nr. 63**

Datë: 29. 09. 2021. Ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Ilir Gashi, Florian Dushi, Ibrahim Selmanaj, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši, Fazli Stollaj.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

### **RENDI I DITËS**

#### **1. Hyrje: z. Čemailj Kurtiši, kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**

- **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nr.61/2021.**

#### **2. Raport i Këshillave të KQZ-së:**

##### **Këshilli për Buxhet dhe Financa:**

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës buxhetore për rregullimin e Qendrës Mediale të KQZ-së;

##### **Këshilli për Operacione Zgjedhore:**

- Shqyrtimi dhe miratimi i zëvendësimit të anëtarit të KQZ-së në komunën e Gllgocit,
- Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për ndryshimin e lokacionit të Qendrës së Votimit 1912e në komunën e Prishtinës,

- Shqyrtimi dhe miratimi i nominimeve për Anëtar të Këshillave të Vendvotimeve (KVV) për Zgjedhjet Lokale të 17 tetorit 2021.
- Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të aktivitetit të Prokurimit.

### 3. Të ndryshme

---

#### **1.Hyrje: z. Čemailj Kurtiši, kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**

**Čemailj Kurtiši:** Konstatojmë që kemi korum, në mungesë të kryesuesit dhe anëtares që mungon Gordanës, ata janë në udhëtim zyrtar, unë sot do të kryesoj këtë mbledhje të 63-të. Ju përsëndes të gjithëve...A ka dikush diçka...?

**Sami Kurteshi:** Kryesues, unë jam për këtë rend të ditës, vetëm nëse është e mundur për shkak të një angazhimi që e kam në orën 2, pika e Këshillit për Operacione Zgjedhore të trajtohen para pikës për Buxhet dhe Financa, meqenëse ndoshta duhet edhe votim dhe duhet të ketë korum...!

**Čemailj Kurtiši:** Siç e dëgjuat kolegun Sami Kurteshi i cili propozon që të ndryshojmë renditjen e pikave: njëherë të jetë Këshilli për Operacione Zgjedhore si pikë e parë ndërsa Këshilli për Buxhet dhe Financa të jetë si pikë e dytë. Shpresoj, s'keni asgjë kundër...

Kush është për ?

Konstatoj që e kemi miratuar njëzëri rendin e ditës, atëherë kalojmë te pika e radhës

#### **2.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nr.61/2021:**

**Čemailj Kurtiši:** Fillojmë shqyrtimin dhe miratimin e procesverbalit nr.61. A keni vërejtje në këtë procesverbal ? Nëse jo, konstatoj se njëzëri është miratuar ky procesverbal.

#### **3.Këshilli për Operacione Zgjedhore**

##### **1.Shqyrtimi dhe miratimi i zëvendësimit të anëtarit të KKZ-së në komunën e Gllgocit:**

**Alim Rama:** Në mbledhje të Këshillit për Operacione Zgjedhore dje së pari e kemi trajtuar zëvendësimin e anëtarit të KKZ-së në komunën e Drenasit ku Këshilli për Operacione Zgjedhore

rekomandon zëvendësimin e Alban Mulaj me anëtarin tjetër Astrit Plakaj, pra të emërohet Astrit Plakaj si anëtar i KKZ nga subjekti Lëvizja Vetëvendosje në komunën Drenas.

**Çemailj Kurtişi:** E dëgjuat z.Rama. Kush është për atë që të zëvendësohet anëtar i KKZ-së në Drenas, dhe Astrit Plakaj të emërohet si anëtar i KKZ-së në vend të anëtarit të mëparshëm Alban Mulaj ? Konstatohet që e kemi miratuar njëzëri...

## **2.Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për ndryshimin e lokacionit të Qendrës së Votimit 1912E në komunën e Prishtinës:**

**Alim Rama:** Faleminderit kryesues, ne po ashtu, në mbledhjen e sotme në bazë të rekomandimit të Sekretariatit të KQZ-së duke marrë parasysh se qendra 1912E në komunë të Prishtinës ndodhet në sallën 1 tetori e cila sallë përdoret për vaksinim dhe imunizim të qytetarëve, kështu që ky vendvotim ose qendër e votimit e zëvendëson lokacioni nga salla 1 tetori në objektet e Fakultetit të Edukimit. Të gjitha vërtetimet dhe konfirmimet janë marrë nga organet përkatëse, kështu që Këshilli për Operacione Zgjedhore rekomandon për zëvendësimin e lokacionit të qendrës 1912E, nga salla 1 tetori në objektet e Fakultetit të Edukimit, ku po ashtu Sekretariati ka marrë udhëzime që të bëjë njoftime të votuesve po ashtu edhe si kërkon ligji që të gjithë votuesit që shkojnë në sallën 1 tetori të udhëzohen të shkojnë në objektet e Fakultetit të Edukimit , kështu që rekomandon për aprovim të kërkesës

**Çemailj Kurtişi:** Ju falënderoj z. Rama për prezantimin. Kush është për miratimin e rekomandimit për ndryshimin e lokacionit të qendrës së votimit 1912E në komunën e Prishtinës ?

Konstatohet që njëzëri e kemi miratuar edhe këtë vendim.

## **4.Raport i Këshillave të KQZ-së**

### **Këshilli për Buxhet dhe Financa:**

#### **Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës buxhetore për rregullimin e Qendrës Mediale të KQZ-së:**

**Ilir Gashi:** Faleminderit, Këshilli për buxhet ka mbajtur mbledhjen dhe ka trajtuar një kërkesë buxhetore për rregullimin e qendrës mediale dhe në bazë të kërkesës ne kemi konstatuar që kërkesa është mirë të miratohet, për faktin që është aktivitetet për rregullimin e kësaj qendëre që lidhet më informimin publik mjetet që janë të destinuara më njëjtin kode buxhetor ekziston dhe janë të mjaftueshme,

kështu se si këshill kemi vendosur së të rekomandojmë para jush për miratimin e kësaj kërkesë faleminderit.

**Čemailj Kurtiši:** E dëgjuat prezantimin, e keni diçka për të thënë...?

**Arianit Elshani:** Faleminderit kryesues, unë vetëm dëshirova të dije në qofte se janë parapare të gjitha elementet që janë të nevojshme për krijimin e kësaj hapësire, dizajnimin e kësaj hapësire për shkak që mos të mbetet diçka pa u përfshirë, shpresoj që ka ndodh që ky aktivitet mos të përfshihet në kuadër të informimit publik, pra të strategjisë së informimit publike dhe në kuadër të buxhetit pra ketë e kam pyetjen a janë të gjitha dhe a përfundon më këtu ky proces dhe tjetra që në raport më zgjedhjet të ketë kujdes që të mos jene këto ndoshta datat e tjerat që mundën më ndryshuar pastaj në rundin e dyte të zgjedhjeve që mund të përdoren për dy runde pra i njëjti material të njëjtat dizajnë të cilat prodhohen, ketë e kam si kërkesë besoj që e merr parasysht sekretariati ketë çështje faleminderit.

**Ilir Gashi: Jo,** siç e thash edhe më herët, qendra mediale është pjesë që lidhet edhe më aktivitetet e informimit publik, besoj së dizajni dhe të gjitha ato janë të parapanë nuk ndryshon përpos përmbajtës asgjë nga ajo që ka qene më 14 shkurt kështu që e kemi trajtuar dhe po mendoj që e kemi menudar që të rekomandohet.

**Čemailj Kurtiši:** A ka edhe dikush diçka? Nëse nuk ka dikush diçka tjetër rekomandoj ta votoni. Kush është për miratimin e kërkesës për buxhet të rregullimit të qëndresë mediale të KQZ-së.

Konstatoj që më një zëri e kemi votuar.

### **Të ndryshme!**

**Čemailj Kurtiši:** A ka dikush diçka për piken të ndryshme? Urdheroni z. Elshani.

**Arianit Elshani:** I kam dy pyetje për sekretariat, një për zyrën e regjistrimit e partive politike dhe një për sekretariat: Kur pritët të përfundoj gjithë procesi i këshillave të vendvotimeve pra, kur po planifikoni gjat kësaj jave që të i trajtojmë këto çështje dhe, të fillojmë trajnimin dhe aktivitetet tjera që pasojnë për sekretariat.

Sa i përket zyrës së regjistrimit të zyrës se regjistrimit të partive politike lidhur më akreditimin e vëzhgueseve, a do te ketë akreditim të ri pra shtese për tu rekomanduar ne KQZ-ë, cilat janë ato subjekte të gjitha këto që jeni tu shqyrtuar një raport nëse mundeni si sekretariat ?

**Čemailj Kurtiši:** Urdheroni z. Buzhala ?

**Besnik Buzhala:** Faleminderit shumë, përshëndetje për të gjithë. Në bazë të planit operacional për zgjedhjet lokale të 17 tetorit, emërimi i KKV-e bëhet prej datës 30 shtator, deri më datën 2 tetor. Kjo është periudha kohore kur KQZ-ë i shqyrton dhe emëron anëtarët e këshillave të vendvotimit. Pas emërimit të KKV-ë, ne mund të fillojmë menjëherë me procesin e trajnimit të tyre.

**Čemailj Kurtiši: A** ka edhe dikush diçka tjetër për të shtuar ose, për tu propozuar?

**Ibrahim Selmanaj:** Edhe unë do të parashtoj një pyetje se, në nivel të organizimit të zgjedhjeve, a është funksionale gjithçka në komunat e Kosovës, duke e pasur parasysh edhe gjendjen që e kemi sidomos në veriun e Kosovës. Pra, a kemi ndonjë zhvillime të ndryshëm apo, është komunikimi i përhershëm dhe nuk kemi ndonjë probleme të theksuar ose, diçka që mundet me na nxjerrë ndonjë problem në këtë proces ?

**Besnik Buzhala:** Sa i përket gjendjes nëpër komunat e Kosovës, të gjitha përgatitjet janë duke shkuar sipas planit operacional, prej raportimit të fundit sidomos të komisionit komunal të zgjedhjeve në komunën e Zveçanit nuk ka ndonjë ndryshim, është gjendja e njëjte, d.m.th, procesi është normal të gjitha komunat e republikës së Kosovës....

**Čemailj Kurtiši: Ju** falënderoj z. Buzhala, shpresoj së gjithçka do të shkoje në rregull, që gjendja të normalizohet, ne si KQZ-ë do të marrim të gjitha të mundshmet që të shkoj gjithçka ne rregull. Nëse nuk keni diçka të shtoni, urdhëroni znj. Valmire?

**Valmire Selmani (ZRPP):** Zyra, është në proces të verifikimit të vëzhgueseve të cilët i kanë dorëzuar subjektet politike por edhe organizatat ndërkombëtare, ku afati ka përfunduar më 27, ndërsa afati përfundimtar për media, është deri më 2 tetor. Jemi në proces të verifikimit, mirëpo deri në mbledhjen e radhës po besoj që shumica e subjekteve politike të cilave ju kemi dërguar edhe shkresa për përmasime dhe korrigjime, do të jete mbledhjen e radhës për akreditime të vëzhguesve të cilët i kanë sjellë...